



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 28.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 25.08.2026 të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P “GRESA COMMERC” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru dhe pelet”, Nr. i prokurimit- 632-26-3785-1-1-1, Nr. i brendshëm - 632-26-022-111, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.T.P “GRESA COMMERC” e dt.25.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru dhe pelet”, Nr. i prokurimit- 632-26-3785-1-1-1, Nr. i brendshëm - 632-26-022-111, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 18.08.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, të publikuar me datë:18.08.2026
- 3. Autoriteti Kontraktues**, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
- 4. Ky vendim hyn në fuqi** ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik N.T.P “GRESA COMMERC”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me dru dhe pelet”, Nr. i prokurimit- 632-26-3785-1-1-1, Nr. i brendshëm - 632-26-022-111.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 28.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka vlerësuar si më psohtë:

- **PRETENDIMIT NR. 1 – Mosndarja e aktivitetit në lote**

Operatori Ekonomik pretendon se furnizimi me dru dhe furnizimi me pelet duhet të ndahen në dy lote të veçanta, me arsyetimin se bëhet fjalë për produkte me prodhues, furnitorë dhe procese të ndryshme furnizimi. Operatori kërkon që aktiviteti të ndahet në LOT 1 – Furnizim me dru zjarri dhe LOT 2 – Furnizim me pelet.

Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me këtë pretendim.

Objekti i aktivitetit të prokurimit është sigurimi i energjentëve për ngrohjen e institucioneve arsimore të Komunës së Gjakovës. Edhe pse druri dhe peleti kanë karakteristika teknike të ndryshme, të dy produktet i shërbejnë të njëjtit qëllim funksional dhe administrativ, përkatësisht sigurimit të ngrohjes së objekteve shkollore gjatë sezonit të ngrohjes.

Aktiviteti është konceptuar si kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, me kohëzgjatje prej 10 muajsh. Furnizimet realizohen vetëm pas lëshimit të urdhërblereve nga Autoriteti Kontraktues, sipas nevojave faktike të institucioneve arsimore, ndërsa vendi i dorëzimit është në shkollat e Komunës së Gjakovës dhe kushtet e dorëzimit janë DDP.

Duke marrë parasysh mënyrën e realizimit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se administrimi përmes një kontrate të vetme siguron:

- një pikë të vetme të përgjegjësisë kontraktuale;
- koordinim të unifikuar të urdhërblereve dhe dërgesave;
- monitorim më efikas të realizimit të kontratës;
- reagim më të shpejtë ndaj nevojave të institucioneve arsimore;
- shmangie të paqartësive lidhur me përgjegjësinë në rast të vonesave ose mungesës së furnizimit;
- menaxhim më ekonomik dhe më efikas të kontratës.

Ndarja e një kontrate në lote përbën një mundësi të Autoritetit Kontraktues dhe jo obligim automatik. Neni 13.2 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se kontratat që përmbajnë mallra homogjene ose heterogjene mund të ndahen në lote, veçanërisht kur kjo vlerësohet e nevojshme për inkurajimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose për zgjerimin e konkurrencës. Dispozita nuk e obligon Autoritetin Kontraktues që çdo furnizim me më shumë se një kategori mallrash ta ndajë domosdoshmërisht në lote.

Dosja e Tenderit nuk kërkon që Operatori Ekonomik të jetë vetë prodhues i drurit dhe i peletit. Kërkohej që operatori të ketë aftësi për sigurimin dhe dorëzimin e produkteve sipas specifikimeve teknike dhe kushteve kontraktuale. Prandaj, operatorët mund t'i sigurojnë produktet nga burime të ndryshme të ligjshme të furnizimit.

Përveç pjesëmarrjes individuale, Dosja e Tenderit lejon pjesëmarrjen si grup i operatorëve ekonomikë dhe deklarimin e nënkontraktimit, duke ofruar mundësi shtesë që operatorët e specializuar të bashkëpunojnë për realizimin e kontratës. Kjo mundësi paraqet argument plotësues dhe jo arsyen kryesore për mosndarjen e aktivitetit në lote.

Strukturimi në një lot zbatohet njësoj ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe nuk përmban kërkesë që favorizon një operator, prodhues, markë apo burim të caktuar furnizimi.

Nga aspekti teknik, funksional dhe organizativ, Autoriteti Kontraktues vlerëson se strukturimi i aktivitetit në një lot të vetëm është i lidhur drejtpërdrejt me nevojat konkrete të furnizimit të institucioneve arsimore dhe me mënyrën e administrimit të kontratës publike kornizë.

Kështu që, pretendimi nr. 1 refuzohet si i pabazuar.

• **PRETENDIMI NR. 2 – Kriteri lidhur me mjetet transportuese**

Operatori Ekonomik kundërshton kërkesën për disponimin e:

- një kamioni me peshë ngarkuese maksimum 7 tonë; dhe
- dy kamionëve me peshë ngarkuese maksimum 5 tonë.

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit të pretendimit të Operatorit Ekonomik, vlerëson se ky pretendim është i pabazuar dhe, si i tillë, refuzohet.

Kontrata në fjalë përfshin furnizimin e disa institucioneve arsimore të Komunës së Gjakovës, sipas urdhërblereve që mund të lëshohen gjatë gjithë periudhës 10-mujore të kontratës. Në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, furnizimet duhet të realizohen brenda tri ditëve nga pranimi i urdhërblertjes dhe gjatë orarit të punës së Autoritetit Kontraktues.

Duke marrë parasysh natyrën e furnizimit, numrin e institucioneve përfituese, lokacionet e ndryshme ku duhet të realizohen dërgesat, si dhe afatin e shkurtër për realizimin e tyre, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se disponimi i së paku tri mjeteve transportuese është i nevojshëm për sigurimin e realizimit efikas dhe në kohë të kontratës.

Kërkesa për mjete transportuese është përcaktuar duke u bazuar në nevojat reale operative të Autoritetit Kontraktues dhe synon, ndër të tjera:

- realizimin e furnizimeve brenda afatit kontraktual prej tri ditësh;
- mundësinë e realizimit të furnizimeve në disa institucione arsimore dhe lokacione të ndryshme;
- sigurimin e kapacitetit të nevojshëm transportues në rast të urdhërblereve të njëkohshme ose të afërta në kohë;
- garantimin e vazhdimësisë së furnizimit në rast të defektit, mirëmbajtjes apo ndonjë pengese tjetër që mund të paraqitet në njërin prej mjeteve;
- sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm për transportimin dhe shpërndarjen e drurit dhe peletit, sipas sasive dhe kërkesave të institucioneve përfituese;
- parandalimin e vonesave në furnizim, të cilat mund të cenojnë funksionimin e sistemeve të ngrohjes në institucionet arsimore.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues konsideron se kërkesa për së paku tri mjete transportuese nuk është e përcaktuar në mënyrë arbitrare, por lidhet drejtpërdrejt me objektin, mënyrën dhe afatet e realizimit të kontratës.

Gjithashtu, kriteri nuk kufizon operatorët ekonomikë në një markë, prodhues, model, vit prodhimi apo origjinë të caktuar të mjeteve. Operatorët ekonomikë nuk janë të detyruar që mjetet t'i kenë në pronësi, pasi disponueshmëria e tyre mund të dëshmohet përmes pronësisë, qirasë apo një marrëveshjeje tjetër të ligjshme për shfrytëzim. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kriteri nuk paraqet kufizim të pajustificuar të konkurrencës.

Andaj, nevoja për së paku tri mjete transportuese, një kamioni me peshë ngarkuese maksimum 7 tonë dhe dy kamionëve me peshë ngarkuese maksimum 5 tonë mbetet e arsyeshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin, numrin e lokacioneve dhe afatin e realizimit të furnizimeve.

- **PRETENDIMIT NR. 3 – Vlera e parashikuar e kontratës**

Operatori Ekonomik pretendon se vlera e parashikuar prej 200,000.00 € nuk është e arsyeshme dhe reale.

Në mbështetje të pretendimit, Operatori Ekonomik ka përdorur çmimin orientues prej rreth 400.00 € për ton pelet dhe 70.00–75.00 € për metër kub dru, duke llogaritur një vlerë të përgjithshme prej rreth 237,440.00 € deri në 238,400.00 €. Autoriteti Kontraktues ka rishqyrtuar bazën e përcaktimit të vlerës së parashikuar dhe konsideron se pretendimi i Operatorit Ekonomik nuk është mbështetur me dëshmi të mjaftueshme dhe të verifikueshme për të provuar se vlera e parashikuar është përcaktuar në kundërshtim me legjislacionin.

Vlera e parashikuar e aktivitetit është përcaktuar para inicimit të procedurës, në kuadër të planifikimit të nevojave, paramasës, parallogarisë, konsumit të planifikuar dhe dokumentacionit të brendshëm të Autoritetit Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues është i vetëdijshme se, sipas nenit 13.1 dhe 13.3 të Rregullores për Prokurimin Publik, parallogaritja duhet të jetë e arsyeshme dhe reale dhe duhet të marrë parasysh çmimet e tregut, kontratat paraprake kur ato ekzistojnë dhe analizën e kostos së specifikimeve relevante.

Megjithatë, llogaritja e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk përbën vetvetiu hulumtim të plotë dhe të krahasueshëm të tregut, sepse:

1. nuk janë identifikuar qartë furnitorët ose burimet e çmimeve të përdorura;
2. nuk është dëshmuar data dhe periudha e vlefshmërisë së çmimeve;
3. nuk është dëshmuar se çmimet i referohen sasive të njëjta dhe furnizimit me shumicë;
4. nuk është dëshmuar në mënyrë të verifikueshme se çmimet përfshijnë specifikimet teknike të tenderit, TVSH-në, transportin dhe të gjitha kushtet DDP;
5. nuk është paraqitur një krahasim me kontrata paraprake të ngjashme të Autoritetit Kontraktues ose autoriteteve të tjera;
6. llogaritja është bërë duke shumëzuar 100% të sasive indikative me çmime orientuese të përcaktuara nga vetë Operatori Ekonomik.

Vetë Operatori Ekonomik deklaron se çmimet do të mbështeten me dëshmi ose oferta, mirëpo në kërkesën e shqyrtuar nuk janë evidentuar oferta konkrete krahasuese që mundësojnë verifikimin e çmimeve të pretenduara. Aktiviteti është kontratë publike kornizë dhe furnizimet do të realizohen përmes urdhërblërjeve, sipas nevojave faktike gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Dosja e Tenderit përcakton shprehimisht se sasi të janë indikative dhe se devijimi i lejuar është $\pm 30\%$.

Edhe Rregullorja për Prokurimin Publik përcakton se sasi të kontratave publike kornizë janë indikative, se mund të lejohet devijimi deri në $\pm 30\%$ dhe se pagesa bëhet vetëm për furnizimet e porositura dhe të pranura.

Për rrjedhojë, shumëzimi i të gjitha sasive indikative me çmime orientuese të paargumentuara nuk është dëshmi e mjaftueshme se vlera e parashikuar e aktivitetit është e paarsyeshme ose joreale.

Vlera e parashikuar nuk duhet të përcaktohet sipas vlerësimit individual të një operatori ekonomik, por sipas një parallogaritjeje të Autoritetit Kontraktues të mbështetur në dokumentacionin e planifikimit, hulumtimin e tregut dhe nevojat e parashikuara për periudhën përkatëse.

Në mungesë të dëshmive konkrete, të krahasueshme dhe të verifikueshme që e rrëzojnë parallogaritjen e Autoritetit Kontraktues, konsideron se nuk ekziston bazë e mjaftueshme për ndryshimin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në këtë aspekt, pretendimi nr. 3 refuzohet si i pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).